**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJGJEVE PËR VITIN 2024**

Periudha (tetor-nëntor)

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 23 | 10.10.2024 | **1.**Nr.e banorëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Bashkisë, sipas çdo muaji nga janari 2024-shtaor 2024? **2.**Nr. e banorëve mbi moshën 18 vjeç me vendbanim në territorin e Bashkisë, sipas çdo muaji nga janar 2024-shtator 2024? **3.**Nr.aktual të personave të verbër me vendbanim në B.Belsh? **4.**Nr.aktual të personave me aftësi të kufizuara me vendbanim ne B.Belsh, të ndarë sipas secilës kategori? **5.**Nr.personave që trajtohen me asistencë sociale me vendbanim në B.Belsh, sipas çdo muaji nga janari 2024-shtator 2024? **6.**emrat e Komuniteteve etno-kulturore që jetojnë në B.Belsh? **7.**Nëse ka komunitete, nr.e popullsisë për secilit komunitet? **8.**Nr.total të nëpunësve në B.Belsh? **9.**Nr.e nëpunësit që gëzojnë statusin e "nëpunësit civil" në B.Belsh? **10.**Nr.e nëpunësve në proçes marrje të "nëpunësit civil" në B.Belsh? **11.**Nr.e nëpunësve me kontratë në B.Belsh, aktualisht? **12.**Emrin dhe kontaktet zyrtare të personit përgjegjës për raportimin dhe komunikimin me KQZ për zgjedhjet parlamentare | 14.10.2024 | **1.**Janar 34576,<br>Shkurt 34581,<br>Mars 34600,<br>Prill 34600;<br>Maj 34609,<br>Qershor 34607,<br>Korrik 34612,<br>Gusht 34652,<br>Shtator 34652.<br>**2.** Përsa i përket numrit të banorëve mbi moshën 18 vjeç me vendbanim në territorin e bashkisë, do ju lutesha ti referoheshit Institutit të Statistikave pasi zyra e Gjendjes Civile Belsh nuk e disponon një ndarje sipas muajve të banorëve mbi 18 vjeç. **3.** 191.<br>**4.** PAK grupi II 572<br>PAK grupi I 161<br>Paratetraplegjikët 21<br>**5.**Janar 545,<br>Shkurt 541,<br>Mars 536,<br>Prill 535,<br>Maj 521,<br>Qershor 519,<br>Korrik 510,<br>Gusht 495,<br>Shtator 479.<br>**6 dhe 7.** Në territorin e bashkisë Belsh ka vetëm një Komunitet etno-kulturor (minoritar), të cilët i përkasin komunitetit Egjiptian, me një numër popullsie prej 350 banorësh.<br>**8.** 230.<br>**9.** 52. | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2025? **13.**Kontaktet zyrtare të Kryetarit të Bashkisë? **14.**Kontaktet zyrtare të Kryetares/it të Këshilli Bashkiak?<br>**15.**Kontaktet zyrtare të Koordinatorit për të drejtën e informimit?<br>**16.**Kontaktet zyrtare të Zëdhënësit apo personit të ngarkuar per Komunikim me Median? **17.**Kontaket zyrtare të institucionit të B.Belsh? | | **10.** 6.<br>**11.**Me kontratë zëvëndësuese nuk ka, ndërsa me kontratë pune janë 178.<br>**12.**Mustafa ÇARÇIU<br>Nr.tel. 069 77 32 368<br>Email:<br>mustafacarciu@gmail.com<br>https://www.facebook.com/mustafa.carciu?mibextid=LQQJ4d<br>**13.** Arif TAFANI<br>Nr.tel. 068 40 11 511<br>Email:<br>arif.tafani01@hotmail.com<br>https://www.facebook.com/profile.php?id=100063701572345&mibextid=LQQJ4d<br>https://www.instagram.com/arif_tafani_faqja_zyrtare?igsh=MmMzZWE5Z2ZzcjNk<br>**14.**Kujtim DERVISHI<br>Nr.tel. 068 40 56 563<br>Email:<br>kujtimdervishi71@yahoo.it<br>https://www.facebook.com/kujtim.dervishi.56?mibextid=LQQJ4d.<br>**15 dhe 16.** Fatmira BROSHKA<br>Nr.tel. 069 37 20 575<br>Eamil:<br>fatmira.broshka@bashkiabelsh.gov.al<br>https://www.facebook.com/fatmira.broshka?mibextid=LQQJ4d<br>https://www.instagram.com/broshka_fatmira?igsh=MTdmMmltbHYwa | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | DE3MA==.<br>**17.** Email: bashkiabelsh@hotmail.com<br>https://bashkiabelsh.al/<br>https://www.facebook.com/bashkiabelsh2015?mibextid=LQQJ4d<br>https://www.instagram.com/bashkia_belsh?igsh=MWFwaWV5Nm9kMXk5dw== | | |
| 24 | 23.10.2024 | **1.**A ka bashkia një Plan Social të miratuar dhe nëse po, kur është miratuar? **2.**A ka aplikuar Bashkia Belsh për të përfituar nga Fondi Social dhe a jeni shpallur fitues në vitin 2024? **3.** Sa ka qenë vlera totale e miratuar nga MSHMS për vitin 2024 dhe për cilat kategori shërbimesh do të përdoren? **4.**A është disbursuar në masën 100% fondi i kushtëzuar i MSHMS për vitin 2024? **5.**A keni përthithur fonde nga Fondi Social për vitin 2023, në çfarë vlere ka qenë fondi i përfituar dhe për cilat kategori shërbimesh janë përdorur? **6.**Sa përqind të fondit të përfituar keni përdorur deri tani të ndarë sipas viteve, 2023 dhe 2024? **7.**A keni parashikuar në buxhetin afatmesëm 2025-2027 ngritje të fondeve për të mbajtur në funksion shërbimet e ofruara në territor edhe pas përfundimit të financimit të Fondit Social? **8.**Cilat janë kategoritë e shtesave vulnerabël të identifikuara në bashkinë tuaj që mund | 01.11.2024 | **1**.Po, bashkia Belsh ka një Plan Social të miratuar me datë 29.12.2023.**2**.Po, bashkia Belsh ka aplikuar me datë 14.12.2023 për të përfituar nga Fondi Social dhe është shpallur fituese për vitin 2024.**3**.Vlera totale e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2024 është 1233900,00 lekë, vlerë e cila do të përdoret për të moshuarit, individët me PAK dhe individët në nevojë.<br>**4**.Fondi i kushtëzuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2024 është disbursuar në masën 100%.**5**.Po, kemi përthithur fonde nga Fondi Social për vitin 2023, i cili ka qenë në vlerën 1233900,00, dhe është përdorur për të moshuarit, individët me PAK dhe individët në nevojë.**6**.Deri më tani është përdorur 100 % e fondit të përfituar për vitin 2023 dhe 100 % e fondit të përfituar për vitin 2024.**7**.Po, kemi të parashikuar në buxhetin afatmesëm 2025-2027 | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të përfitojnë nga shërbimet sociale? | | ngritje të fondeve për të mbajtur në funksion shërbimet e ofruara në territor edhe pas përfundimit të financimit të Fondit Social.<br>**8**.Kategoritë e shtresave vulnerabël të identifikuara në bashkinë tonë që mund të përfitojnë nga shërbimet sociale, janë të moshuarit edhe fëmijët me aftësi të kufizuara. | | |
| 25 | 28.11.2024 | 1.Cili është stausi i tregut Blegtoral-Bujqësor dhe problematikat nëse ka?<br><br>2.A është planifikuar event inagurues dhe kur? | 28.11.2024 | Tregu Blegtoral-Bujqësor ka përfunduar sipas projektit, në të cilin bashkia Belsh ka përfituar nga Skemat Mbështetëse në vitn 2022.Megjithatë tregu nuk është në funksion, pasi fermerët deri më tani nuk kanë shfaqur interes për të tregtuar në këtë treg. | E plotë | Pa pagesë |
| 26 | 28.10.2024 | **1**.Sa është buxheti vjetor i bashkisë tuaj? Sa prej tij shpenzohet për projekte sociale? Ka ndodhur të mbeten fonde pa u shfrytëzuar? (Ju lutem të dhënat për 3 vitet e fundit).**2.** A keni aplikuar në institucionet qëndrore me projekte në thirrjet që hapen? Sa aplikime keni paraqitur? Sa herë bashkia juaj ka rezultuar fituese? Kur nuk rezultoni fitues, cilat janë arsyet që ju penalizojnë? (të dhënat në shifra 3 vitet e fundit)**3**. Cili është projekti i fundit që keni aplikuar? Si i hartoni projektet, a keni ekip pune të posaçëm, të trajnuar?**4**. Në zonën tuaj sa familje ka që trajtohen me ndihmë ekonomike? Sa familje kanë persona që trajtohen me kemp? Sa dhe si ju | 05.11.2024 | **1**. 2022-366,7 milion lekë 2023-408,5 milion lekë;<br>2024-420,3 milion lekë;<br>Në këto tre vite buxheti i parashikuar për projekte sociale ka qenë:<br>2022 – 5 milion lekë;<br>2023 - 5 milion lekë;<br>2024 - 10 milion lekë;<br>Në të treja vitet kanë mbetur fonde të pashfrytëzuara nga buxheti i parashikuar për projekte sociale.<br>**2**.Projekti "*Përmirësimi i kushteve të banesave të familjeve në nevojë*", projekt i aplikuar nga Drejtoria për Planifikimin, Zhvillimin dhe Kontrollit të Territorit pranë bashkisë Belsh, në thirrjen e hapur nga Ministria e Financave (Drejtoria e Strehimit Social). Ky projekt është aplikuar në tre vitet e fundit 2022,2023,2024 dhe | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mund t'i mbështesë bashkia juaj këta persona?**5**. Sa familje janë të pastreha në bashkinë tuaj? | | nuk ka rezultuar fitues. Projekti është skualifikuar për mosplotësimin e disa kritereve nga Komisioni i Vlërësimit të Projekteve pranë Drejtorisë së Strehimit Social.<br>Projekti "*Kujdesi për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara është kujdesi për komunitetin"*, projekt i aplikuar nga Zyra e Ndihmës Ekonomike pranë bashkisë Belsh, në thirrjen e hapur nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për vitin 2024 (korrik 2024-dhjetor 2024), projekt i cili ka rezultuar fitues.<br>Projekti "*Fondi Social në lidhje me Qendrën Multifunksionale "Nderim Brezash*" ,projekt i aplikuar nga Zyra e Ndihmës Ekonomike pranë bashkisë Belsh, në thirrjen e hapur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, projekt i cili ka rezultuar fitues që nga viti 2021 e deri më tani.<br>**3**.Projekti i fundit i aplikuar është projekti "*Kujdesi për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara është kujdesi për komunitetin"*, projekt i aplikuar nga Zyra e Ndihmës Ekonomike pranë bashkisë Belsh, në thirrjen e hapur nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për vitin 2024 (korrik 2024-dhjetor 2024).<br>Këto projekte janë hartuar nga zyrat e lartpërmendura dhe jo nga një ekip pune i posaçëm i trajnuar. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **4**.Në territorin e bashkisë Belsh janë 479 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 1119 persona që trajtohen me kemp. Bashkia Belsh ofron edhe shërbim fizioterapie dhe logopedie për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe shërbim fizioterapie për të rriturit.<br>**5**.Në territorin e bashkisë Belsh janë 39 familje me shtëpi të pabanueshme nga fatkeqësi të ndryshme natyrore. | | |
| 27 | 27.11.2024 | 1.Numri total i punonjësve të bashkisë Belsh, emër/mbiemër dhe poziocionin e tyre të punës?<br>2.Lista e emrave të kryetarëve të fshatrave? | 02.12.2024 | 1.Listë me numrin total të punonjësve të bashkisë Belsh, emër/mbiemer dhe pozicionin e tyre të punës.<br>2.Listë me emrat e kryetarëve të fshatrave të bashkisë Belsh. | E plotë | Pa pagesë |